

Procesverbal

Nga Mbledhja e VIII-të e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më: 25.09.2025

Rendi i ditës

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i materialeve të Kuvendit për mbledhjen VIII të rregullt;
3. Eventuale.

Miralem Rahte – Të nderuar anëtarë të pranishëm të komitetit, të nderuar mysafirë, e hap mbledhjen e VIII të rregullt të Komitetit për Komunitete në vitin 2025. Para fillimit, do të doja t'i pyesja anëtarët e komitetit nëse e kanë marrë materialin në kohën e paraparë ligjore. A ka ndonjë koment apo vërejtje mbi materialin? Meqë nuk ka, vazhdojmë më tej.

Mbledhja e sotme ka tri pika. Pika e parë është shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Komitetit, shqyrtimi i materialeve të Kuvendit për mbledhjen e tetë dhe pika e tretë pika Eventuale. A dëshiron dikush të marrë fjalën lidhur me rendin e ditës? Meqë nuk ka, e vë rendin e ditës për votim. Kush është për? Për? Kundër? Të përmbajtur? Nuk ka.

Kalojmë në pikën e parë, shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Komunitete. A dëshiron dikush të marrë fjalën... Procesverbali nga mbledhja e shtatë. A ka ndonjë koment? E vë për votim pikën e parë. Kush është për? Kundër? Të përmbajtur? Nuk ka. Kalojmë në pikën tjetër, shqyrtimi i materialeve të Kuvendit për mbledhjen e tetë.

Në materialin e Kuvendit kemi gjashtë pika, sipas praktikës së zakonshme pika e parë dhe e fundit, por këtu edhe pika dyta, e kalojmë. Nuk e shqyrtojmë në Komitet, ajo i përket vetë Kuvendit.

Kalojmë menjëherë në pikën e tretë. Anulimi i vendimit për ndryshimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për parcelat e zonës kadastrale Plavë. A ka ndonjë diskutim? E vë këtë pikë për votim. Kush është për? Kundër? Të përmbajtur?

Pika e ardhshme është pika e katërt, miratimi i deklaratës mbështetëse në deklaratën për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë. A ka dikush që dëshiron të flasë? Meqë nuk ka, e vë edhe këtë pikë për votim. Kush është për? Kundër? Të përmbajtur?

Kalojmë më tej. Propozim-vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Dragashit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027 dhe 2028. A ka dikush që dëshiron të flasë? Meqë nuk ka, e vë për votim. Kush është për? Kundër? Të përmbajtur? Kjo ishte pika e fundit nga materialet e Kuvendit.

Kalojmë në pikën e tretë, pikën Eventuale. A ka ndonjë diskutim? A kemi ndonjë kërkesë? Siç e dimë të gjithë, kemi marrë një kërkesë. Kërkesë për shqyrtimin e një kërkesë të mëparshme. Kështu shkruan këtu. Kërkesa është dërguar nga Fehim Sali, fshati Krstec, Komuna e Dragashit. Kërkesa thotë: "Të nderuar, ju drejtohem juve si një organ brenda strukturave komunale që

përcjell punën e komunës në të gjitha sferat. Meqë në planin zhvillimor të komunës sonë thuhet se...” Këtu ka disa gabime. Të gjithë anëtarët e komitetit e keni marrë kërkesën.

Nedžmidin Sejdilar – Ju faleminderit zoti kryesues. E kam shfletuar shkurtimisht këtë kërkesë, përkatësisht vetëm faqen e parë dhe shoh se nuk është e shkruar në asnjërin nga gjuhët zyrtare. Në këtë kërkesë ka shumë terma dhe fjalë që unë nuk i kuptoj dhe do të kërkoja që parashtruesi i kërkesës ta shkruajë atë në mënyrë të rregullt në njërin nga gjuhët zyrtare, që shërbimi i Kuvendit ta përkthejë siç duhet dhe pastaj ta shqyrtoj. Në këtë formë, unë kam shumë terma që nuk i kuptoj dhe nuk jam në gjendje të vendos paanshëm dhe në mënyrë adekuate për këtë kërkesë. Prandaj propozoj që kjo kërkesë të refuzohet si jo serioze dhe që z. që e ka dërguar, të na e dërgojë një të re, të shkruar në njërin nga gjuhët zyrtare dhe në mënyrë të kuptueshme. Faleminderit.

Miralem Rahte – Faleminderit z. Nedžmidin. A ka dikush tjetër? Nëse jo, unë do të flas. Përshëndetje edhe njëherë. Kërkesën, z. Nedžmidin, unë e kam kuptuar pjesërisht. Ka kohë deri në Kuvend që ta sqarojmë më mirë. Ta lexojmë më qartë, sepse edhe unë e kam marrë së fundmi dhe nuk kam pasur kohë për analizë më të detajuar. Por kjo kërkesë ka të bëjë me faktin që vetë Kuvendi ta shqyrtojë, që të mos ketë diskriminim në shqyrtimin e saj. Prandaj propozoj që ta votojmë dhe ta dërgojmë në Kuvend. Pastaj, çfarëdo që vendos Kuvendi, ashtu mbetet. Faleminderit.

Nedžmidin Sejdilar – Zoti kryesues, nëse unë nuk e kam kuptuar këtë kërkesë, e cila është tentuar të shkruhet në njërin nga gjuhët zyrtare, konkretisht në serbisht, vështirë se do ta kuptojë dikush tjetër në Kuvend. Prandaj propozoj që të refuzohet si jo serioze, të informohet parashtruesi dhe të kërkohej që, nëse ai vetë nuk është i aftë ta shkruajë, të konsultojë juristë apo ndonjë gjuhëtar për të hartuar një kërkesë të kuptueshme. Unë pashë 4–5 terma vetëm në faqen e parë që nuk i kuptoj dhe që më krijojnë konfuzion. Nuk e di si të vendos në Kuvend mbi një tekst të tillë. Për shkak të seriozitetit të punës së Komitetit për Komunitete, sepse të gjithë e dimë sa vendime serioze kemi marrë për këto katër vite, ju lus të mos pranojmë kërkesa të tilla dhe as t’i dërgojmë në Kuvend. Thjesht ta lusim zotërinë që ta dërgojë një kërkesë më serioze. Gjë tjetër që më habit është se këtë kërkesë e kanë dërguar dy kompani serioze. Imagjinoni, dy kompani serioze të mos jenë në gjendje ta shkruajnë kërkesën në një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës që ne ta kuptojmë. Vetë kërkesa, sipas meje, është jo serioze. Për seriozitetin tuaj, seriozitetin e Kuvendit, të pushtetit komunal dhe të gjithëve ne, lus që kjo të mos shkojë në Kuvend. Sepse si mendoni se do të veprojnë unë në Kuvend kur një kërkesë e tillë të vijë? Është krejtësisht jo serioze. Nuk mund t’i kuptoj ata biznesmenë që duan të ndërtojnë Centraleve/turnibave të erës, hidrocentrale e çka jo tjetër, e nuk janë në gjendje të dërgojnë një kërkesë të rregullt te organet komunale, respektivisht te Komiteti për Komunitete dhe Kuvendi. Faleminderit.

Miralem Rahte – Faleminderit, z. Nedžmidin. Ky është vendimi juaj. Kush është Për që këtë kërkesë, si komitet, ta përcjellim në Kuvend? Dhe të kërkojmë përgjigje pse nuk është futur në rendin e ditës të Kuvendit. Kush është për – 2? Kundër – 1? Të përmbajtur – 3? A ka dikush që dëshiron të flasë? Meqë nuk ka, e mbyll mbledhjen e sotme të Komitetit për Komunitete.

Kryesues i Komitetit për Komunitete
Miralem Rahte